



INSTITUCIONET E BASHKIMIT EUROPIAN DHE POLITIKAT E MIGRACIONIT KLIMATIK

Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri
(EMA)

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

29 prill 2025



IMPROVING KNOWLEDGE FOR CLIMATE JUSTICE
AND HUMAN RIGHTS IN ALBANIA

JusticeForClimate


1

PËRMBLEDHJE

- Përkufizimi i Migracionit Klimatik
- Teoritë e Migracionit Klimatik
- Kuadri institucional i BE-së
- Politikat e duhura
- Referenca

08/01/2025 2

2



A MENDONI SE NDRYSHIMET
KLIMATIKE JANË SOT NJË
NDËR SHTYTËSIT KRYESORË
TË MIGRIMIT?

08/01/2025 3

3

PËRKUFIZIMI I MIGRACIONIT KLIMATIK

- Migracioni klimatik përkufizohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) si "Lëvizja e një personi ose grupe personash të cilët, kryesisht për arsye të ndryshimeve të papritura ose të vazhdueshme në mjedis për shkak të ndryshimeve klimatike, janë të detyruar të largohen nga vendbanimi i tyre i zakonshëm, ose të zgjedhin ta bëjnë këtë, për kohësisht ose përgjithmonë, brenda një shteti ose përtej një kufiri ndërkombëtar."

08/01/2025 4

4

MIGRANTË KLIMATIKË

- Termi 'migrant' është përdorur gjerësisht, përfshirë nga IOM. Megjithatë, përdorimi i fjalës 'migrant' mund të mos konsiderohet gjithmonë i përshatshëm, pasi nënkupton një shkallë vullneti në vendimin për t'u zhvendosur.
- Migrimi i tyre shpesh është një strategji adaptive, një zgjedhje për të përmirësuar jetesën në kushtet e përkeqësimit të mjedisit.

REFUGJATË KLIMATIKË

- Refugjatët klimatikë** janë ata persona që detyrohen të largohen nga vendbanimi i tyre për shkak të një rreziku të menjëhershëm për jetën, sigurinë ose shëndetin si pasojë e fenomeneve ekstreme klimatike.
- Megjithatë, termi "refugjat klimatik" nuk njihet nga ligji ndërkombëtar: sipas Konventës së Gjenevës për Refugjatët (1951), një refugjat është dikush që ikën nga persekutimi për shkak të racës, fese, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose opinioneve politike, pra **ndryshimet klimatike nuk përfshihen** në këtë përkufizim. (UNHCR, 2021)

08/01/2025 5

TEORITË E MIGRACIONIT KLIMATIK

Myers (2001) popullarizoi konceptin e refugjatëve mjedisorë dhe parashikoi rritjen e zhvendosjes të shkakuar nga ndryshimet klimatike, veçanërisht në rajone si Afrika Sub-Sahariane dhe disa pjesë të Azisë.


Kritika e kësaj teorie deterministe: Rëndësi e tepruar faktorëve mjedisorë, duke mos marrë në konsideratë faktorët sociale, politikë dhe ekonomikë që gjithashtu ndikojnë në modelet e migracionit.



08/01/2025 6

MIGRACIONI KLIMATIK: QASJE ADAPTUESE

- Një nga kuadrot konceptuale më të njohura është kuadri i Foresight (2011), që shpeshon lidhjen midis ndryshimeve mjedisore dhe migracionit.
- Ky model përfshin elemente nga teoria neoklasike, përzgjedhja selektive e migrantëve dhe modeli push-pull.
- Sipas Foresight, ndryshimet klimatike janë faktore të terthorë që ndikojnë ekonomike, demografike, sociale, politike dhe mjedisore ekzistuese.
- Raporti i Foresight thekson "migrimin si formë adaptimi" duke e konsideruar atë një strategji të rëndësishme politike ndaj sfidave klimatike dhe mjedisore (De Sherbenin et al, 2022).



08/01/2025 7

KUADRI INSTITUCIONAL I BE-SË

Bashkimi Europian (BE) ka një kuadër institucional të strukturuar për të menaxhuar sfidat e ndryshimeve klimatike dhe migracionit, me një rol të rëndësishëm për të adresuar çështjet e migracionit të shkakuar nga faktorë klimatikë. Ky kuadër është i ndërtuar mbi disa institucione kryesore që bashkëpunojnë për të zhvilluar dhe zbatuar politikat dhe legjislacionin që lidh ndryshimet klimatike dhe migracionin. Politikat e migracionit klimatik janë të ndërlidhura ngushtë me objektivat e BE-së për zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si një nga vlerat kryesore të unionit.

08/01/2025 8

KOMISIONI EUROPIAN

KE propozon legjislacionin e ri dhe siguron implementimin e politikave të BE-së. Komisioni menaxhon gjithashtu buxhetin e BE-së dhe veprimet e jashtme, përfshirë ndihmën humanitare dhe zhvillimin.

Drejtoritë relevante për menaxhimin e politikave të migracionit klimatik:

DG CLIMA (Drejtoria e Përgjithshme për Veprim Klimatik) menaxhon politikat e ndryshimeve klimatike dhe ofron mbështetje për shtetet anëtare për të arritur objektivat e Paktit të Gjelbër Europian.

DG HOME (Drejtoria e Përgjithshme për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme) në fokus në menaxhimin e migracionit dhe integrimin e migrantëve, si dhe zhvillon politikat për sigurinë e brendshme.

DG ECHO (Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen Civile Europiane dhe Operacionet e Ndihmës Humanitare) koordinon përgjigjen ndaj krizave dhe ofron ndihmë për shtetet që përballen me katastrofa natyrore ose situata emergjente.

Faqja zyrtare: https://commission.europa.eu/index_en



08/01/2025 9

PARLAMENTI EUROPIAN

Parlamenti Europian është organi legjislativ i drejtpërdrejtë i Bashkimit Europian, dhe përfshijon qytetarët e shteteve anëtare të BE-së. Deputetët e Parlamentit Europian janë të zgjedhur nga qytetarët në zgjedhjet europiane çdo pesë vjet. Parlamenti Europian ka një rol të rëndësishëm në miratimin e legjislacionit, përfshirë ligje që lidhen me migracionin dhe ndryshimet klimatike.

Në lidhje me **politikat e migracionit të klimës**, Parlamenti Europian ka promovuar ndërjegjesimin për pasojat e ndryshimeve klimatike mbi migrimin dhe ka mbështetur propozime që lidhin politikat e emigracionit me ato të mjedisit dhe zhvillimit. Parlamenti gjithashtu diskuton dhe miraton masat që ndihmojnë individët që janë detyruar të migrojnë për shkak të katastrofave natyrore dhe ndryshimeve klimatike.

Faqja zyrtare: <https://www.europarl.europa.eu/portal/en>



08/01/2025 10

KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN

Këshilli i Bashkimit Europian është një organ i rëndësishëm politik i BE-së, i cili përbëhet nga liderët e shteteve apo qeverive të vendeve anëtare të BE-së. Këshilli ka një rol kyç në vendimmarrjen dhe vendosjen e politikave, dhe vepron në bashkëpunim me KE dhe PE. Një aspekt i veçantë i Këshillit të BE-së është se ai ka një **presidencë rotative**, që ndëron çdo 6 muaj. Kjo do të thotë që çdo shtet anëtar i BE-së merr përsipër detyrën e kryesimit të Këshillit për një periudhë gjashtëmujore, duke përcaktuar axhendën dhe duke udhëhequr mbledhjet dhe diskutimet e Këshillit.

Momentalisht, këtë presidencë e kryeson **qeveria polake** që nga 1 janari 2025 deri më qershor 2025, duke u bërë pjesë e një trioje të re që përfshin Poloninë, Danimarkën dhe Qipron.

<https://www.consilium.europa.eu/en/council-eu/>



08/01/2025 11

AGJENCIA EUROPIANE PËR MJEDISIN (EEA)

Agjencia Europiane për Mjedisin (EEA) është përgjegjëse për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave mjedisore në BE, duke ndihmuar në zhvillimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe adresimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Ajo ofron raporte dhe analiza të gjendjes mjedisore, përfshirë pasojat e ndryshimeve klimatike dhe ndikimet e tjera mjedisore, që ndihmojnë në formulimin e politikave të përshatshme. EEA ka një rol të rëndësishëm në mbështetje të politikave për migracionin klimatik, duke ofruar informacion mbi rajonet më të rrezikuara nga katastrofat natyrore dhe duke ndihmuar në krijimin e strategjive për menaxhimin e migracionit të shkaktuar nga ndryshimet klimatike.


Faqja zyrtare: <https://www.eea.europa.eu/en>



08/01/2025 12

PËRGJIGJJA E BASHKIMIT EUROPIAN

- Në vitin 2018, Komisioni Europian bëri një propozim për të trajtuar shkaqet kryesore të migracionit të paligjshëm, përmes krijimit të një fondi për azilin, migracionin dhe integrimin. Ky propozim lidhet me **Paktin e ri për migracionin dhe azilin**, i publikuar në shtator të vitit 2020, i cili ka për qëllim mbrojtjen e statusit të refugjatëve dhe propozimin e integritetit me të mirë të migrantëve të ligjshëm. **Megjithatë, ky pakt nuk trajton ndryshimin e klimës si një arsye të rëndësishme për migracionin.**
- Në vitin 2020, Komiteti Ekonomik dhe Social Europian (EESC) theksoi rëndësinë e një përkufizimi të saktë të migracionit klimatik, duke përgatitur përpjekjet për të matur përmasat e problemit dhe për ta adresuar atë.



PËRGJIGJJA E BASHKIMIT EUROPIAN

- **Më 12 korrik 2023**, Parlamenti Europian miratoi amendamente për një ligj të restaurimit të natyrës. Ky rregullim është një hap kyç për të shmangur kolapsin e ekosistemeve dhe për të parandaluar pasojat më të këqija të ndryshimeve klimatike dhe humbjes së biodiversitetit.
- **Më 15 qershor 2023**, Parlamenti Europian kërkoi që **15 korriku** të shpallësi Dita e BE-së për viktimat e krizës globale të klimës, për shkak se më 15 korrik 2021, përmbytjet në Gjermani dhe Belgjikë vranë më shumë se 200 persona, për të rritur ndërgjegjësimin për jetën e humbura njerëzore dhe krizën humanitare të shkakuar nga ndryshimi i klimës.

POLITIKAT E DUHURA?

- Sipas Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), hapi i parë është përdorimi i fuqisë publike dhe angazhimeve për të siguruar veprime më ambicioze kundër ndryshimit të klimës, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit, për të ulur rolin e saj si shkak i lëvizjes njerëzore. **Rekomandimet kyçe përfshijnë:**
- Shmangia e kthimit të migrantëve në territore të prekura nga ndryshimi i klimës dhe respektimi i parimit themelor të mos-kthimit (*principle of non-refoulement*) për të mbrojtur ata që nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës;
- Lehtësimi i përfshirjes së migrantëve në komunitetet pritëse, rregullimin e statusit të tyre dhe qasjen e tyre në tregjet e punës;
- Forcimi i rolit të organeve rajonale në trajtimin e mobilitetit njerëzor të lidhur me ndryshimet klimatike. Angazhimi me mekanizmat e të drejtave të njeriut, duke përfshirë mbikëqyrjen, rishikimin dhe mbështetjen teknike të përmirësuar për çështjen e lëvizjes ndërkufitare të lidhur me ndryshimin e klimës.

REFERENCA

- de Sherbinin, Alex, et al. "Migration Theory in Climate Mobility Research." *Global Environmental Change*, vol. 72, 2022, p. 102441 <https://www.frontiersin.org/journals/climate/articles/10.3389/feclm.2022.882343/full>
- European Parliament Research Service Briefing. The concept of 'climate refugee' Towards a possible definition, October 2023. https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BBJE/2021/698753/JPRES_BBJE2021698753_EN.pdf
- Foresight: Migration and Global Environmental Change (2011) Final Project Report The Government Office for Science, London. <https://epmms.ac.uk/224757/1/1-1114-migration-and-global-environmental-change.pdf>
- Myers, N. (2001). *Environmental Refugees: A Growing Phenomenon of the 21st Century*. Philosophical Transactions of the Royal Society Biological Sciences. <https://citeseerx.ist.psu.edu/document?repid=rep1&type=pdf&doi=264620ca77e023da240d61143235001aa1ec5cc>
- OHCHR <https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/ClimateChange/materials/2PMigration1ight.pdf>
- UNHCR (2021). *Legal considerations regarding claims for international protection made in the context of the adverse effects of climate change and disasters*. <https://www.refworld.org/policy/legalguidance/unhcr/2020/en/123356>

FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN TUAJ!

Për çdo pyetje, mund të kontaktoni në

 gledis.gjipali@em-al.org

01/01/2025 17